REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3938 Prot. Maliq, më 26.06.2026

VENDIM
Nr.77, datë 25.06.2026

PËR
"MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TE VARRIMIT"

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nënpika 1.1, gërma "b",ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, ligjit 9220 datë 15.04.2004 *"Për shërbimin publik të varrimit"*, i ndryshuar me ligjin nr. 80/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligjit 9220 datë 15.04.2004 *"Për shërbimin publik të varrimit"*, neni 6/b pika 2, si dhe ligjit nr.121/2016 *"Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"*, neni 36 roli i bashkisë pika 1,2,3, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

I. Të miratojë kriteret mbi mbulimin e shpenzimeve të varrimit

1. Shpenzimet e shërbimit të varrimit kryhen nga njësia bazë e qeverisjes vendore ku individi është i regjistruar.
2. Përfitues të këtij shërbimi janë personat që jetojnë në kushtet e varfërisë, të braktisjes, të mungesës së interesit mes anëtarëve të familjes, ose për të cilët është e pamundur të identifikohen familjarë që bartin detyrimin, sipas pikës 1, të nenit 6 të ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", i ndryshuar me ligjin nr. 80/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligjit 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit".
3. Administratori i Njësisë përkatëse dhe punonjësi social sigurojnë dokumentacionmin e nevojshëm për këtë shërbim si, akt vdekje, certefikate vdekje, lejë varrimi dhe relacion shpjegues mbi arsyet e përfitimit të këtij shërbimi.
4. Deklarimi i vdekjes bëhet nga personat më të afërt tëfamiljes dhe, në mungesë të tyre ose për personat pa njeri, nga Administratori i Njësisë Administrative ku I ndjeri ka gjendjen civile.
5. Procedura do te realizohet rast pas rasti sipas legjislacionit te prokurimit public me kerkese nga sherbimi social .

II. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar.

Miratuar me 21 vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 26.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

